



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:287347

Datë: 06.12.2024

Numri i dokumentit: 06558756

K.DH.SHK.II.nr.2148/24

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryetar, Dren Rogova dhe Faton Bajrami anëtarë, në padinë e paditësit-propozuesit Eurovia Shpk me NUI 810611261, me seli ne Prizren, e përfaqësuar nga avokati Visar Ostrozubi, kundër të paditurit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SHA me seli ne Fushe Kosovë, me bazë juridike, anulimi i aktvendimit me nr. 109/32024 dt. 30.09.2024 me propozim për shtyrjen e kërkesës për konfiskimin e sigurisë se kontratës se prokurimit me shifer kmd-20-954-2-1-1, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit-paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Administrative, nr. KA.nr.512/24 të datës 15.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit-propozuesit- "Eurovia Shpk me NUI 810611261, me seli ne Prizren.

II. PRISHET Aktvendimit i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, nr. KA.nr.512/24 të datës 15.10.2024 dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, Gjykatës Komerciale, Dhomës se Shkallës se Parë.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin e ankimuar të gjykatës se shkalles e pare nr. KA.nr.512/24 të datës 15.10.2024, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit-propozuesit Eurovia Shpk me NUI 810611261, me propozim për shtyrjen e kërkesës për konfiskimin e sigurisë se kontratës se prokurimit me shifer kmd-20-954-2-1-1.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi-propozuesi, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata të aprovoj ankesën si të bazuar, të prish aktvendimin e ankimuar dhe lendet te kthej ne rishqyrtim dhe rivendosje ose te ndryshohet aktvendimi i atakuar gjykatës komerciale

në Kosovë, ashtu qe te aprovohet propozimi për shtyhet sekuestrimi i garancionit , nr. Police 070010140005907 dt. 30.09.20021.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 194 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-se, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

-Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditës ne gjykate ka parashtruar padi për anulimi i aktvendimit me nr. 109/32024 dt. 30.09.2024 me propozim për shtyrjen e kërkesës për konfiskimin e sigurisë se kontratës se prokurimit me shifër kmd-20-954-2-1-1.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas kërkesës se paditësit është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit-propozuesit Eurovia Shpk me NUI 810611261, me propozim për shtyrjen e kërkesës për konfiskimin e sigurisë se kontratës se prokurimit me shifer kmd-20-954-2-1-1, duke vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 22 par.6 lidhur me paragrafin 2 të këtij nenit të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që nuk ka gjetur asnjë provë të vetme me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin dhe nenin 182 par.2 pika n) dhe 183 të LPK-së, e që përbejnë arsye për anulimin e këtij aktvendimi, dhe nenit 22 te LKA-se dhe nenit 13 paragrafin 1, pika 1.12 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, pasi qe, arsyetimin i vendimit te atakuar është jashtë objektit kontestit.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetveten si dhe ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës. Kolegji i kësaj gjykate ne baze te shkresave te lendes- përkatësisht te padisë me kërkesën për shtyrje te dt. 29.08.2024 te paditësit, shihet se paditësi-propozuesi ka kërkuar nga gjykata e shkallës se pare shtyrjen e ekzekutimit garancionit , nr. Police 070010140005907 dt. 30.09.20021 dhe jo shtyrje e vendimit te paditurës siç ka vendos gjykata e shkalles se pare me vendimin e atakuar, andaj vendimi i atakua i shkalles e pare është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 182 par.2 pika n) dhe 183 të LPK-së, e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e*

aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Mungojnë arsyet dhe faktet vendimtare, ndërsa të njëjtat as nuk janë arsyetuar, në përputhje me provat në shkresa të lendes. Kolegji pas elaborimit të arsyetimit të vendimit atakuar dhe provave të cilat gjenden në shkresa të lendes konstaton se arsyetimin i vendimit atakuar është jashtë objektit kontestit. Gjykata nuk mund të pajtohet me arsyetimin e vendimit atakuar për faktin se vlerëson vendimi i atakuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me kërkesën e paditësit dhe shkresat e lendes, andaj një vendim i tillë nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore të LPK. Gjykata vlerëson se e vendimi i atakuar nuk i është përgjigjur bazës-propozimit të kërkesës së paditësit.

Sipas Nenit 22 paragrafi 6 *“Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni”*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh *“Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Me nenin 22, paragrafi 6 i ligjit të cekur është përcaktuar se paditësi mund të kërkojë nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.*

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me të paditurin kanë qene në raport kontraktuar, në bazë të kontratës me shifër kmd-20-954-2-1-1, e paditura Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SHA me seli në Fushe Kosovë në baze të aktvendimit me nr. 109/32024 dt. 30.09.2024 e ka ndërprerë kontratën me Operatorin Eurovia SHPK. E paditura si Ndërmarrjet Publike SH.A është Shoqëri Aksionare dhe nuk është organ administrativ dhe vendimet saj nuk i plotëson kushtet ligjore të një vendimi administrativ, pasi që e paditura nuk është institucion i ngarkuar me autorizime publike, që të nxjerr vendime administrative, sepse vendimet administrative duhet të merren duke zbatuar një procedurë administrative e që në rastin konkret dokumenti i tillë fare nuk ka të bëjë procedurë administrative. Akti administrativ konsiderohen të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike për persona fizikë dhe juridikë. Veprimtaria administrative është tërësia e akteve individuale ose kolektive administrative të nxjerra nga organet e administratës publike gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre si dhe veprimet e kryera nga administrata për zbatimin e këtyre akteve.

Me nenin 22, paragrafi 6 i ligjit të cekur është përcaktuar se paditësi mund të kërkojë nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni. Mirëpo paditësi nuk ka kërkuar nga gjykata

shtyrjen e vendimit kontestues, por ka kërkuar shtyrjen e kërkesës për konfiskimin e sigurisë së kontratës së prokurimit me shifer kmd-20-954-2-1-1, për të cilën kërkesë nuk ka qene kompetent Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje administrative i Gjykatës Komerciale e Kosovës për arsye se, ne bazë ete nenit 13 pika 1.12. te ligjit për gjykatën Komerciale 08/L-015 përcakton se *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative.*

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji vlerëson se me aktvendimin e atakuar gjykata e shkalles së parë nuk ka vlerësuar drejtë kompetencën e saj lëndore sepse palët kontraktues janë ne raport kontraktuese dhe janë te barabarta ne këtë raport dhe nuk nënshtrohet vullnetit të palës tjetër përkatësisht nuk kemi te bëjmë me padi ne konflikt administrative, pasi qe e padatuara nuk e ka cilësinë e organit administrative mirëpo është Ndërmarrjet Publike si Shoqëri Aksionare. Kolegji konsideron se në marrëdhëniet kontraktuale subjektet janë të barabarta, pavarësisht nga statutet e veta që kanë në shoqëri, të barabarta janë edhe vullnetet e tyre. Në këtë mënyrë vullneti i njëjës palë nuk i nënshtrohet vullnetit të palës tjetër, siç është në të drejtën dhe në marrëdhëniet administrative. Barazia e palëve dhe e vullneteve të tyre është parashikuar edhe me nenin 3 të Ligjit Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), sipas së cilës dispozitë pjesëmarrësit në marrëdhënien detyrimore janë të barabartë.

Kolegji i gjykatës, se shkallës së dytë, shqyrtoi përfundimin e mësipërm të gjykatës së shkallës së parë, aktvendimi e goditur si dhe të gjitha shkresat e lëndës dhe gjeti se një aktvendimi i atakuar është përfshirë ne shkeljet thelbësor te dispozitave ligjor edhe vërtetemi te gabuar te gjendjes faktike, sepse nuk ka mbështetje në shkresat e lëndës. Po ashtu, kjo Gjykatë gjeti se aktvendimi i goditur është i përfshirë nga shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe kontestimore dhe vërtetim te gabuar te gjendjes faktikë të parashikuara nga neni 182 dhe 183 të LPK, për çfarë u desh që ky aktvendim të priset, për arsye se aktvendimi ka te meta për shkak te cilave nuk mund te ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktvendimit, arsyetimi i është i mangët, si dhe arsyet e dhëna janë te paqarta ekzistojë kundërthënie ne mes për faktet vendimtare ne mes asaj qe jepet ne arsyet e aktvendimit dhe kërkesës se paditësit dhe provave te cilat gjenden ne shkresa te lendes. Prandaj rezulton e qartë se arsyetimi i aktvendimit të goditur nuk ka mbështetje në kuptim të provave në shkresa të lëndës, kështu që të gjitha këto shpien në përfundimin se gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të propozimit të paditësit -propozuesit nuk i ka vlerësuar fillimisht kompetencën lëndore ne bazë te Ligjit për gjykatën Komerciale dhe LPK.

Bazuar në të lartëcekurat, rezulton se gjykata e shkallës së parë aktvendimi e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 22 te LKA-se dhe nenit 8 të LPK-së. Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara dhe në ri procedurë duhet të eliminohen te gjitha shkeljet e lartëtheksuara si dhe të vlerësoj kompetencës e saj dhe pastaj të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejt.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 209 pika d) e LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.2148/23, me datë 29.11.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi